



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:085982

Datë: 12.11.2024

Numri i dokumentit: 06438914

PKR.nr.571/11

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Krimeve të Rënda, i përbërë nga Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari Gazmend Bahtiri, me anëtarët – gjyqtarët profesionist Alltën Murseli dhe Gëzim Ademi, me bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri dhe zyrtaren ligjore Dalina Kërqeli – Abdullahu - procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve S.I. dhe N.I., secili veç e veç për shkak të veprave penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK), e cila është (ri – kualifikuar në fjalën përfundimtare nga prokurori i shtetit nga vepra penale në bashkëkryerje - vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 paragrafi 1, nën paragrafi 3 dhe 9, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPRK-së) si dhe Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, të evidentuar me shenjën PP.nr.539-4/2011, të datës 24.10.2011, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor – publik, të datës 5 nëntor 2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit A.H., të pandehurit S.I. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokat A.K., të pandehurit N.I. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokat G. V., publikisht shpalli, ndërsa me datë 12 nëntor 2024, përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1. S.I., me nofken S., nga i ati ... dhe e ëma ... (e vajzërisë ...), i lindur me datë në ..., ku edhe jeton, me adresë, lagja ... rruga e ..., me numër personal të identifikimit, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion: elektrikist, punon në biznes privat, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në masën e paraburgimit nga data 28 korrik 2011 deri me datë 21 dhjetor 2011, si dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 21 dhjetor 2011, deri me datë 21 shkurt 2012.

2. N.I., nga i ati ... dhe e ëma ... (e vajzërisë ...), i lindur me datë ... në, me vendqëndrim në ..., me adresë, lagja, me numër personal të identifikimit, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer fakultetin - bachelor, me profesion: elektrikist, punon në biznes privat, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në masën e paraburgimit nga 28 korrik 2011 deri me datë 21 dhjetor 2011, si dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 21 dhjetor 2011, deri me datë 21 shkurt 2012.

Konform nenit 362 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPPRK),

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

I. Me dashje që t'i shkaktojnë lëndime trupore të dëmtuarit me qëllim hakmarrjeje, në atë mënyrë që me datën 27 korrik 2011, rreth orës 22:40 minuta, në sallën sportive në fshatin B...., Komuna e, derisa ishin duke luajtur volejball, fillimisht fjalosen, e pastaj shkaktohet një përleshje mes të pandehurve në njërin anë dhe të dëmtuarit D. në anën tjetër, por me ndërmjetësimin e lojtarëve të tjerë që gjendeshin aty, rrahja ndërpritet, mirëpo, të pandehurit me qëllim që t'i hakmerren, shkojnë te vetura e tyre e cila gjendej në parkingun e sallës, ku i pandehuri S. e merr revolen e kal.7.65mm., ndërsa i pandehuri N... një shufër metalike, hyjnë të dy brenda në lokalet e sallës me qëllim që t'a prisnin të dëmtuarin që të dilte dhe kur i njëjti tentoj të del nga salla, i pandehuri S. ia drejton revolen, mirëpo i dëmtuari përpiqet të ia heqë nga dora por nuk arrin sepse i pandehuri S...., arrin të gjuaj një herë dhe e godet në këmbë, rrëzohet e pastaj edhe i pandehuri N...., brutalisht e godet me shufër metalik në pjesë të ndryshme të trupit ku i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore, ndërsa të pandehurit ikin nga vendi i ngjarjes.

Me këto veprime secili nga të pandehurit (veç e veç) kishin për të kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 të KPRK-së.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor me datë 05 nëntor 2024, meqenëse për veprën e ri kualifikuar ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Kundër të pandehurve S.I. dhe N.I., me shënimet personale të përshkruara si më sipër, konform nenit 362 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

II. Me datën 27 korrik 2011, kanë mbajtur pa autorizim armën e tipit “vzor”, me nr. serik D50887, e kal. 7.65mm., e cila është konfiskuar nga ana e policisë.

Me këto veprime secili nga të pandehurit (veç e veç) kishin për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328 paragrafi 2 të KPRK-së.

Për shkak se kjo vepër penale është përfshirë me Ligjin Nr. 04/L-209 për Amnistinë, datë 11 korrik 2013, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 39, datë 19 Shtator 2013.

URDHËROHET konfiskimi i armës – revole cz. Vzor 70 cal 7.65, me numër serik D80287 dhe një karikator i zbrazur, ashtu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi DETYROHET Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, të bëjë shikimin dhe asgjësimin e tyre.

Shpenzimet e procedurës penale – paushalle, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar D. A., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës penale

Ish Prokuroria e Qarkut në Prishtinë – tani Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, në gjykatën e Qarkut në Prishtinë – tani Gjykata Themelore Prishtinë - Departamenti i Krime të Rënda, me datë 24 tetor 2011, ka paraqitur aktakuzën me shenjë PP.nr.539-4/2011, të datës 24 tetor 2011, kundër të pandehurve S.I. dhe N.I., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 paragrafi 1, nën paragrafi 3 dhe 9, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPRK-së, si dhe secili veç e veç kanë kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 të KPRK-së.

Shqyrtimi gjyqësor

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimet gjyqësore në të cilat shqyrtime kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë, me përjashtim të dëmtuarit D. A., përkundër ftesave dhe urdhëresave të kësaj gjykate për verifikim adrese dhe dorëzim ftese, në bazë të të cilave ka rezultuar se i njëjti nuk jeton në Kosovë, përkatësisht gjendet jashtë vendit.

Gjykata fillimisht sqaron se në shqyrtimin gjyqësor të datës 19 shtator 2024, në raport me veprën e dytë të përshkuar si në dispozitiv të aktakuzës, e cila iu është vënë në barrë të te pandehurve nga organi i akuzës mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 të KPRK-së, e njëjta vepër është përfshirë në Ligjin Nr. 04/L-209 për Amnistinë, për të cilën në përfundim të shqyrtimit gjyqësor do të bie aktgjykim refuzues.

Të pandehurit e lartshënuar janë deklaruar jo fajtor lidhur me veprën penale në bashkëkryerje - vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 paragrafi 1, nën paragrafi 3 dhe 9, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPRK-së.

Po ashtu gjatë këtij procesi gjyqësor, gjykata ka bërë administrimin e provave (personale dhe materiale), ku në rastin konkret është bërë dëgjimi i dëshmitarit H. M., pastaj (me pëlqimin e

të gjitha palëve në procedurë) janë administruar provat: Deklarata e të dëmtuarit D. A. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 21 dhjetor 2011, deklarata e dëshmitarit S. Sh. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 21 dhjetor 2011, deklarata e dëshmitarit G. M. e dhënë në Polici me datë 28 korrik 2011, si dhe është bërë leximi i provave materiale si vijon: Vërtetimi mbi konfiskimin e armës, i datës 28 korrik 2011, me të cilën vërtetohet se ditën kritike është sekuestruar arma revole VZ kalibrit 7-65 mm me një karikator të zbrazët, mendimi i ekspertit mjeko-ligjor i datës 12 shtator 2011 si dhe plotësimi i ekspertizës i datës 24 shtator 2024 i cili plotësim është bërë bazuar në dokumentet mjekësore të vitit 2011 të të dëmtuarit por që nuk kanë qenë në posedim të ekspertit mjeko - ligjor me rastin e dhënies së mendimit të parë për të dëmtuarin D.A. lidhur me natyrën e lëndimeve, Raporti mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes i datës 27 korrik 2011 si dhe fotografitë e njësitit të forenzikës nga këqyrja e vendit të ngjarjes.

Fjala përfundimtarë e palëve

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 05 nëntor 2024 prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga aktakuza, duke deklaruar si vijon: “Në këtë shqyrtim gjyqësor sipas aktakuzës me shenjë PP.nr.539-4/2011, të datës 28 tetor 2011 të akuzuarit S.I. dhe N.I. akuzohen për veprën penale në bashkëkryerje vrasje në tentativë sipas ri-kualifikimit të datës 19 shtator 2024 nga neni 172 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe secili veç e veç ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 të KPRK-së. Sa i përket veprës nga pika I pas administrimit të provave, leximit të deklaratës të të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit, dëshmitarit tjetër S... por edhe nga dëshmitari i sotëm H.... M..., vërtetohet dhe nuk është kontestues fakti se ditën kritike në mes të pandehurve dhe të dëmtuarit ka ekzistuar një mosmarrëveshje, se ka pasur një përleshje në me tyre dhe se ka krisur arma nga e cila të dëmtuarit i është shkaktuar plaga e konstatuar edhe në ekspertizën mjeko - ligjore si plagë tejshkuese në regjionin e poshtëm të gjurit të majtë. Në këtë shqyrtim gjyqësor fakti kontestues dhe i pa vërtetuar ka qenë vetëm dashja e të pandehurve për privimin nga jeta të të dëmtuarit D. dhe se dashja si element qenësor i figurës së kësaj vepre penale nuk është arritur të vërtetohet me asnjë provë se të pandehurit ditën kritike kishin qëllim privimin nga jeta të të dëmtuarit bazuar edhe në faktin se nga deklarata e vet të dëmtuarit e dhënë në shqyrtim gjyqësor vërtetohet se arma ka shkrepur derisa ka qenë në dorën e S. dhe të njëjtën i dëmtuari ka tentuar të ia heqë nga duart, në ato momente ka ardhur deri te shkrepja e saj fakt ky i deklaruar edhe nga dëshmitari H.... i cili në shqyrtimin e sotëm deklaroj se arma ka shkrepur në momentet kur i dëmtuari me të pandehurin kanë qenë në përleshje e sipër ndërsa dëshmitari Skënder Shabani në shqyrtimin gjyqësor nuk ka deklaruar se ka qenë prezent si

dëshmitarë okular në momentin e shkretpjes së armës. Andaj në rrethana të tilla sa i përket veprës penale nga pika I e dispozitivit bazuar edhe në nenin 3 paragrafi 2 të Kodit Penal përkatësisht parimit “in dubio pro reo”, me ç ‘rast mëdyshjet mbi ekzistimin e fakteve të rëndësishme zbatohen në favor të te pandehurve, nenit 7 përkatësisht detyrimit të prokurorit të shtetit për vërtetimin e saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, faktin se barra e të provuarit bie mbi organin e ndjekjes i cili duhet të vërtetohet secilën provë për të bindur një vëzhgues objektiv përtej çdo dyshimi dhe se vetëm dyshimi arsyeshëm nuk është i mjaftueshëm për shpalljen e të pandehurit fajtor, andaj në rrethana të tilla në mungesë të dashjes për privimin e të dëmtuarit nga jeta prokuroria fillimisht bënë ri-kualifikimin veprës penale në vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së si ligj më i favorshëm dhe bazuar në nenin 106 dhe 107 për këtë vepër penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, po ashtu sa i përket dispozitivit të dytë bazuar në nenin 2 dhe 3 paragrafi 1 nënpika 1.25 të ligjit L 04-209 për amnistinë për veprën penale të armëmbajtës e kryer para vitit 2013 sipas këtij ligji ndjekja penale për këto vepra penale është amnistuar, andaj në rrethana të tilla në kuptim të nenit 51 të KPPK-së, për shkak të rrethanave të lartcekura tërhiqemi nga ndjekja penale e mëtutjeshme dhe gjykatës i propozojmë që të nxjerr aktgjykim refuzues”.

Vendimi i gjykatës për marrjen e aktgjykimit refuzues

Gjykata në vazhdim do të sqaroj arsyet me të cilat është vendosur që në këtë çështje penale, të bie aktgjykim refuzues. Në raport me dispozitivin e parë të aktakuzës, marrë parasysh faktin se Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare fillimisht e ka bërë ri-kualifikimin veprës penale nga vepra penale në bashkëkryerje - vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 paragrafi 1, nën paragrafi 3 dhe 9, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPRK-së, në veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së (për arsyet të cilat janë dhënë më sipër) e pastaj i njëjti është tërhequr nga ndjekja penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ashtu që kjo gjykatë ka marrë aktgjykim refuzues duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 362 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.3 të KPPRK-së. Sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 të KPRK-së, e cila i është vënë në barrë të te pandehurve S.I. dhe N.I., për të cilën gjykata në shqyrtimin e datës 19 shtator 2024, ka konstatuar se e njëjta është përfshirë në amnisti, fakt të cilin e ka potencuar edhe prokurori i shtetit si më sipër në fjalën përfundimtare, andaj konform nenit 362 paragrafi 1, pika 1.3 të KPRK-së, ka marrë aktgjykim refuzues.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve është marrë konform nenit 328 paragrafi 5 të KPK-së lidhur me nenin 276 paragrafi 2, pika 2.1 të KPPRK-së, andaj kjo gjykatë ka urdhëruar konfiskimin e armës – revole cz. Vzor 70 cal 7.65, me numër serik D80287 dhe një karikator të zbrazur, si mjete që janë përdorur për kryerjen e veprës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor janë marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt juridiko civil është marrë konform nenit 457 paragrafi 1 dhe 2, ku është përcaktuar se: “*Kërkesa pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale vendoset me propozimin e personave të autorizuar në procedurën penale në qoftë se kjo nuk e zvarrit procedurën në mënyrë të konsiderueshme ... Kërkesa pasurore juridike mund të përfshijë kompensimin e dëmit, kthimin e sendit ose anulimin e një veprimi të caktuar juridik*”. Në rastin konkret gjykata sqaron se pala e dëmtuar D. A., nuk ka prezantuar në shqyrtimet gjyqësore në këtë çështje penale, përkundër ftesave dhe urdhëresave të kësaj gjykate për verifikim adrese dhe dorëzim ftese, në bazë të te cilave ka rezultuar se i njëjti nuk jeton në Kosovë, përkatësisht gjendet jashtë vendit, për çka nga këto arsye është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 362 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.3 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.47/20, me 12 nëntor 2024

Zyrtare ligjore,
Dalina Kërçeli - Abdullahu

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.